

**Nr. 2502/005 K (e-k) Prot.**  
**Tiranë, më datë 07/02/2025**

**Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**  
**Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve**  
**Z. Ilirjan CELIBASHI**

**Komisionit të Ankimimeve dhe**  
**Sanksioneve**

**Lënda: DENONCIM Nr.2 – Lidhur me**  
**Projektligjin "Për disa shtesa dhe**  
**ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të**  
**drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me**  
**burgim dhe të paraburgosurve" dhe të**  
**Vendimit të Këshillit të Ministrave për**  
**dhënien e mendimit mbi të.**

**I nderuar z. Komisioner!**

**Të nderuar Drejtues të Administratës së KQZ-së!**

**Të nderuar Anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve!**

Më datën 23 dhjetor 2024, në Kuvendin e Shqipërisë është depozituar [projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"](#), i propozuar nga deputeti Nasip Naço.

Ky projektligj është **ende duke u diskutuar në komisione dhe pritet të miratohet** në seancat e ardhshme plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Projektligji ofron përfitime të drejtëpërdrejta për kategori të caktuara të popullsisë, konkretisht të atyre që vuajnë dënimin në sistemin peniteciar në vend.

Ai ofron rregullim të kuadrit ligjor **duke u dhënë mundësi më të shpejta të dënuarve të kalojnë në një institucion me një nivel më të ulët të sigurisë**, përfshirë këtu edhe të dënuarit pranë institucioneve të sigurisë së lartë, bazuar në një vendim të një komisioni administrativ të burgjeve, Komisionit të Vlerësimit të Rrezikshmërisë së të Dënuarve, ndryshe nga rregullimi aktual i cili parashikon këtë proces vetëm mbi bazën e vendimit të gjykatës.

Po ashtu projektligji ofron mundësinë e kalimit në Institucionet e hapura të vuajtjes së dënimit për të dënuarit me burgim që e vuajnë atë pranë institucioneve të sigurisë së ulët dhe që u ka mbetur më pak se 2 vjet e 6 muaj burgim për të vuajtur, duke ndryshur kushtin prej 6 muajsh që është aktualisht i parashikuar nga ligji.

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailingaddress:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Konkretisht, në [relacionin e këtij projektligji](#), citohet ndër të tjera se:

“... propozimi për ndryshimin e metodologjisë së klasifikimit të sigurisë së të denuarve synon të rrisë efikasitetin e procesit, duke e bërë atë më të shpejtë dhe më pak të ngarkuar për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm. ...

Ne këtu kontekst sugjerohet të shtohet pas pikës 4 të nenit 16 të ligjit 81 /2020 pika 4/1 me këtu përmbajtje;

"4.1. Përjashtimisht nga parashikimet e mësipërme Komisioni i Vlerësimit të Rrezikshmerisë së të Denuarve **vendos kalimin e të denuarve nga një institucion i sigurisë së lartë në një institucion të sigurisë së zakonshme** me kërkesë të drejtorit të institucionit, të denuarit ose të perfagesuesit ku ekzekutohet vendimi ndaj të denuarit, në rast se i denuari ka kryer jo më pak se 2/3 e denimit .. ". ...

Verehet se **nuk ka një përcaktim të tillë për kalimin nga një institucion i sigurisë së lartë në një të sigurisë së zakonshme pas një afati të caktuar kohor** ndryshe nga parashikimet që ligjvënasi ka parashikuar për kalimin e personave nga siguria e zakonshme në siguri të ulët. ...

Përparësi jepet sigurisë dhe rregullave të drejta, **duke lejuar që të denuarit** që kanë demonstruar sjellje të mirë dhe kanë përmbushur kushtet e tjera, **te kalojnë në një institucion me një nivel më të ulët të sigurisë, ...** .

Rregullimi i këtij momenti në ligj do të ulë numrin e kërkesave për ndryshim të klasifikimit të sigurisë në gjykatë, pa cenuar të drejtën e paleve për të ushtruar të drejtën e ankimit pranë gjykatës kompetente. ...

Amendimi i nenit 20 pika 1.

Propozimi për amendimin e nenit 20, pika 1 e Ligjit nr. 81 /2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim dhe të paraburgosurve" **synon të zgjerojë kushtet për kalimin në një institucion të hapur dhe të përfshijë procesin e vendimmarrjes për këto kalime**, bazuar në një vlerësim me gjithëpërfshirës të rrezikshmerisë dhe rrethanave sociale të të denuarit. ...

Ne nenin 20 pika 1 të behen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme:

1.Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Institucioni i hapur është institucioni ose seksioni ku ekzekutohen denimet ndaj:

a) të denuarit me burgim, të cilët **i ka mbetur më pak se 2 vjet e 6 muaj burgim për të vuajtur**, me kusht që i denuari të ketë siguruar një kontratë të rregullt pune në institucionin e hapur, kur raporti i komisionit të vlerësimit të rrezikshmerisë së të denuarve vlerëson se nuk përben rrezik për sigurinë e institucionit apo të shoqërisë;

b) të denuarit me gjysmëliri. " ...

Argumentimi juridik:

**Zgjerimi i kushtit për të përfshirë të denuarit që u kanë mbetur deri në 2 vjet e 6 muaj burgim** mundeson një periudhë më të gjatë dhe më efektive për përgatitjen e tyre për rikthimin në shoqëri, veçanërisht nëpërmjet punësimit të rregullt, i cili është një faktor kyç për suksesin e riintegrimi. ...

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Konkretisht referuar statistikave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në Republikën e Shqipërisë numri total i të denuarve dhe paraburgosurve është 5031 të denuarve me burgim, ... .

... Nga këta 637 janë të denuar për vrasje dhe 1543 për vepra penale të tjera. Në institucionet e sigurisë së lartë vuaj në denimin 496 të denuar ndërsa në institucionet e sigurisë së zakonshme 1129 të denuar. ...”

Presidenti i Republikës ka dekretuar si datë për zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare, datën 11 maj 2025.

Kodi Zgjedhor në nenin 91 “Ndalimi i përdorimit të burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore”, pika 4 përcakton se: “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve **ndalohet** propozimi, **miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë**, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., **përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore**”.

Po në vijim të këtij neni, Vendimi nr. 9 datë 20.12.2020 i Komisionit Rregullator, i ndryshuar, në nenin 3 “Veprimtari të ndaluara”, pika 3 përcakton se: “Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve **ndalohet** propozimi, **miratimi i akteve ligjore ose nënligjore, ose nxjerrja e tyre me qëllim informimin e publikut në lidhje me vendimmarrjen e institucionit miratues në faqen e tij zyrtare, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë**, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, faljet e kamatvonesave, të gjobave, të detyrimeve tatimore e doganore vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore ose të epidemisë/pandemisë, apo ka si qëllim zbatimin e një detyrimi ligjor me karakter ndërkombëtar apo zbatimin e një vendim gjyqësor të formës së prerë.”

Po në këtë Vendim, në pikën 5 përcaktohet se: “Në zbatim të ndalimit të përcaktuar në pikën 3, të këtij neni, **Kryetari i Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave marrin masa për të mosvendosur ose propozojnë të mos vendosen në rend të ditës të institucioneve respektive për shqyrtim dhe miratim, aktet e përmendura në pikën 3 të këtij neni**”.

Bazuar në këto parashikime periudha e ndalimit është periudha **11 janar 2025 deri më shtator 2025**, kur pritet të miratohet Qeveria e re nga Kuvendi i dalë nga zgjedhjet e 11 majit 2025.

Në mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, të datës 27 Janar 2025, ku u diskutua dhe votua, si Komision Parlamentar për dhënie mendimi, edhe Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, pas prezantimit të tij nga z. Nasip Naço si deputeti propozues, deputetët e opozitës anëtarë të Komisionit, znj. Dhurata Çupi e z. Enkelejd Alibeaj **u bënë me dije të gjithë anëtarëve të Komisionit se ky projektligj është në shkelje të hapur të Kodit Zgjedhor. (Shihni për më shumë fjalën e znj. Çupi, minuta 1:58:29-1:59:55 dhe të z. Alibeaj, minuta 2:26:38-2:27:48 e [video-regjistrimit të mbledhjes](#))**

Address:  
Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:  
P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Madje znj. Çupi solli në vëmendje të anëtarëve mundësinë e manipulimit të mekanizmit për efekt të orientimit të votës së të dënuarve prej drejtuesve të institucionit të burgjeve, sikurse ka ndodhur në zgjedhjet vendore 2023 në burgun e Rrogoshinës e Peqinit. (minuta 2:04:01-2:04:43 e [video-regjistrimit të mbledhjes](#)).

Po ashtu përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë, e ftuar në mbledhjen e Komisionit, kërkoi që vendimmarrja e Komisionit të ishte në përputhje me Kodin Zgjedhor duke thënë ndër të tjera se: "... duke tërhequr vëmendjen dhe me një thirrje edhe për Komisionin që të jetë në përputhje me Kodin që duhet të kemi vënë në kodin e sjelljes së institucioneve publike sipas Vendimit 9 të KQZ-së". (minuta 2:44:49 - 2:45:40 e [video-regjistrimit të mbledhjes](#)).

Dukshëm pavarësisht se i gjithë informacioni i nevojshëm ligjor është bërë me dije për deputetët nuk pati asnjë reagim prej tyre dhe as prej drejtuesit të mbledhjes. Në përfundim, kryesuesi i mbledhjes z. Eduard Ndreca i ftoi deputetët për të votuar duke miratuar kështu projektligjin me votën *pro* të 14 deputetëve socialistë, anëtarë të komisionit.

Edhe në [Mbledhjen e datës 28 Janar 2025](#) të Komisionit për Sigurinë Kombëtare, si Komisioni Parlamentar përgjegjës, sërish deputetët e opozitës ngritën shqetësimin e shkeljes së Kodit Zgjedhor për natyrën e projektligjit, por mbledhja, e drejtuar nga kryetari z. Nasip Naço, deputeti propozues i projektligjit, konkludoi me vijimin e procesit në pritje edhe të mendimit prej Këshillit të Ministrave.

Gjithashtu, më datën 5 shkurt 2025, Këshilli i Ministrave mori [Vendimin "Për dhënien e mendimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar"](#).

KRIIK vlerëson tërë këtë proces, të analizuar dhe paraqitur më sipër, në drejtim të miratimit të projektligjit **jo vetëm në shkelje të hapur të Kodit Zgjedhor, por edhe si një sfidë të Deputetëve të maxhorancës socialiste, të vetë Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave ndaj zbatimit të ligjit**, duke përcjellë një mesazh tejet negativ dhe flagrant në dëm të zbatimit të ligjit, të ndërtimit të shtetit ligjor, si dhe **të vetë standardeve të procesit zgjedhor të 11 majit 2025**.

**KRIIK**, bazuar në parashikimet e Kodit Zgjedhor, **denoncon përpara Komisionit Qendror të Zgjedhjeve tentativën për miratimin e këtij projektligji**, duke ju kërkuar që të ndërmerrni sa më parë **hapat e nevojshëm për të parandaluar ecurinë e mëtejshme të tij**.

Në gjykimin e KRIIK, përpos verifikimit të gjithë sa më sipër në raport me hapat proceduralë të nevojshëm, **konsiderohet e nevojshme që Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve t'i tërheqë vëmendjen Kryetares së Kuvendit dhe kërkojë zbatimin e ligjit duke marrë masa për të mosvendosur në rendin e ditës të komisioneve dhe të seancës plenare të Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve".**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania

Gjithashtu, shihet më vend që **Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve të konstatojë mosrespektimin e ligjit nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave**, i cili, në zbatim të nenit 3 pika 5 të Vendimit nr. 9 datë 20.12.2020 të Komisionit Rregullator, duhet të kishte marrë masa për të mos vendosur në rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit

të Ministrave, më datën 5.02.2025, projektvendimin “Për dhënien e mendimit Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar””.

Nxitet Komisioni Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve që të zbatojë me rigorozitet gërmën e ligjit duke nisur hetimin administrativ lidhur me këtë shkelje të Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9 të Komisionit Rregullator, si dhe vendosur sanksionet përkatëse në zbatim të nenit 171 të Kodit Zgjedhor.

**Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi,**

**Me konsideratë,**

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim  
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

**Premto GOGO**

**Kryetar**

**Address:**

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

**Mailingaddress:**

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania